



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА  
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_ г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 2 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i panjohur KSHPK (në tekstin e mëtejshëm) në seancën e54-të, të mbajtur më 01.11.2021, morri vendimin vijues:

## VENDIM

Denoncimi i regjistruar me numër 12-821/1 më 22.02.2021, me pohime për angazhim të pabazuar të personave me kontratë pune në Agjencinë për Nxitjen dhe Zhvillimin e Bujqësisë (ANZHB) - ///, REFUZOHET.

KSHPK-ja konstatoi se në pajtim me Ligjin për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, nuk ka elemente për veprim kompetent, për arsye se në denoncimi ka pohime të cilët KSHPK-ja tashmë ka vepruar për të njëjtat pohime dhe ka marrë vendim, brenda kompetencës së tij.

Lënda me numër 12-821/11 të datës 22.02.2021 të mbyllet dhe të arkivohet .

Vendimi i KSHPK-së, me arsyetim - në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

## Arsyetim

Më datë 22.02.2021 është dorëzuar kërkesa nga një parashtrues i panjohur me pohime për angazhim të pabazuar të personave me kontratë pune në Agjencinë për Nxitjen dhe Zhvillimin e Bujqësisë (ANZHB) - /// dhe është formuar lënda me numër 12-821. /1 datë 22.02.2021.

Në denoncim parashtruesi thekson se në vend të personave me diplomë nga Fakulteti i Bujqësisë janë punësuar me kontratë një sërë personash me profesione ekonomike, juridike, pedagogjike dhe të tjera, dhe se vendet e punës së këtyre personave nuk korrespondojnë me Ligjin për sistematizimin e vendeve të punës në Agjenci. Parashtruesi kërkon që Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit të marrë masa për eliminimin e fenomeneve të tilla.

Për faktin se në denoncim ka pohime se KSHPK-ja tashmë ka vepruar në një rast me të njëjtat pohime, për të cilën ka marrë vendimin me nr. 12-5535/2 më 08.01.2021 e cila është publikuar në ueb -faqen e komisionit, KSHPK vendosi si në dispozitën e këtij vendimi.

Përgatiti: A.R.M.

Miratoi: KN, anëtar i KSHPK-së

**KOMISIONI SHTETËRORË PËR  
PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT  
KRYETAR,  
Biljana Ivanovska**

